



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:065866

Datë: 08.01.2019

Numri i dokumentit: 00210362

P.nr.778/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË–Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me sekretaren juridike Nushe Kadrija, në lëndën penale kundër të pandehurit H. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 08.01.2019, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

H. K., nga i ati I., e ëma S., e gjinisë J., data e lindjes . . . në Gjakovë, ku edhe tani jeton në rrugën “. . .” pn, i divorcuar, i pa shkolluar, punëtor, romë, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal: . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 13.09.2018, rreth orës 22:00/h minuta, në Gjakovë në parkun e qytetit në rrugën “. . .-së” pa autorizim posedon narkotik dhe substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 14 të Ligjit për Barnat Narkotike Substancave Psikotrope dhe Prekusore nr.02/L-128 dhe atë lloj marihuane, në atë mënyrë që gjatë ndalimit dhe kontrollit të pandehurit nga patrulla e policisë njësi DHTN në Gjakovë, tek i pandehuri në xhepin e vogël të pantallonave janë gjetur dy qese të vogla najloni të mbushura me substancë në formë bari, ngjyrë e gjelbërt, e dyshuar për narkotik e tipit “Marihuanë” ku nga ekzaminimi laboratorik në DHTN në Pejë të pranuar me datë 20.09.2018 është konstatuar se D#1, kishte në posedim 0.99 gram, substancë narkotike të llojit Marihuanë.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne kuptim të nenit 495 të KPP-së, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti Përgjithshëm, për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr1401/18, të datës 11.10.2018.

Andaj, gjykata ne kuptim të nenit 4, 41, 43 par.1 pika 1.3, nenit 46, 73, 74 dhe nenit 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit ia shqipton:

D Ë N I M I N M E G J O B Ë

Në lartësinë prej 400 (dyqind) Euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata i'a zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

Ndaj të akuzuarit shqiptohet edhe

D Ë N I M I P L O T Ë S U E S

Ashtu që konfiskohen: substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë neto të përgjithshme prej 0.99 ± 0.0001 gram, si objekt i veprës penale.

Detyrohet i pandehuri që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: shpenzimet e paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë–Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr1401/18, të datës 11.10.2018, kundër të pandehurit H. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do ti shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 të KPP-së dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë nga: Raporti i oficerit Sh. S. me numër të rastit 2018-DHTN-83, i datës 26.05.2018, Dëftesa mbi

konfiskimin e pronës e datës 13.09.2018, Raport i testit fushor i datës 20.09.2018, foto dokumentacioni, deklaratat e të pandehurit e dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë me datë 13.09.2018 si dhe shkresat tjera në lëndë u vërtetua se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohen, andaj gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, që në të ardhmen i pandehuri të mos kryej ndonjë veprë penale të paraparë me ligj.

Përveç dënimit kryesor, gjykata ndaj të akuzuarit, ka shqiptuar edhe dënimin plotësues konfiskimin e substancës narkotike, konform neneve 62, 69 dhe 275 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale edhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 par.1 dhe par.2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë, në kuptim të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.778/18, me datë 08.01.2019

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykses,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Nëse i pandehuri nuk parashtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.

Numri i lëndës: 2018:065866
Datë: 08.01.2019
Numri i dokumentit: 00210362